

## PROJEKT ZBATIMI

OBJEKTI: "RIKONSTRUKSION I RRUGES AUTO GJIMNAZI FUSHE-  
ARREZ"



KORRIK 2016

# SPECIFIKIME TEKNIKE

## KAPITULLI 1

### TE PERGJITHSHME

#### TABELA E PERMBAJTJES

- 1.1 TE PERGJITHESHME
- 1.2 VENDI NDERTIMIT
- 1.3 ZEVENDESIMET
- 1.4 DOKUMENTAT DHE VIZATIMET
- 1.5 KOSTOT PER MOBILIZIM DHE PUNIME TE PERKOHESHME
- 1.6 HYRJA NE SHESHIN E NDERTIMIT
- 1.7 FURNIZIMI ME UJE
- 1.8 FURNIZIMI ME ENERGI ELEKTRIKE
- 1.9 PIKETIMI I PUNIMEVE
- 1.10 FOTOGRAFITE E SHESHIT TE NDERTIMIT
- 1.11 BASHKEPUNIMI NE ZONE
- 1.12 MBROJTJA E PUNES DHE PUBLIKUT
- 1.13 MBROJTJA E AMBIENTIT
- 1.14 TRANSPORTI DHE MAGAZINIMI I MATERIALEVE
- 1.15 PASTRIMI PERFUNDIMTAR I ZONES
- 1.16 PROVAT

## **1.1 Te pergjitheshme**

Paragrafet ne kete kapitull jane plotesuese te detajeve te dhena ne Kushtet e Kontrates. Investitori i objektit eshte Bashkia Fushe-Arrez.

## **1.2. Vendi i ndertimit**

Vendi i ndertimit eshte ne territorin e Bashkise Fushe-Arrez sipas plan-vendosjeve.

## **1.3. Zevendesimet**

Zevendesimi i materialeve te specifikuar ne projekt do te behet vetem me aprovimin e Mbikqyresit te Punimeve dhe investitorit.

## **1.4. Dokumentat dhe vizatimet**

Sipermarresi do te verifikojte te gjitha dimensionet, sasite dhe detajet te treguara ne vizatimet, grafiket, ose te dhena te tjera. Punedhenesi nuk do te mbaje pergjegjesi per ndonje mangesi ose mosperputhje te gjetur ne to. Sipermarresi do te marre persiper te gjitha pergjegjesite ne berjen e llogaritjeve te madhesive, llojeve dhe sasive te materialeve dhe paisjeve te perfshira ne punen qe duhet bere sipas kontrates.

## **1.5. Kostot e sipermaresit per mobilizim dhe punime te perkoheshme**

Do te kihet parasysh qe sipermarresit nuk do ti behet asnje pagese mbi cmimet njesi te kuotuar per kostot e mobilizimit d.m.th. per sigurimin e transportit, drite, energjine, veglat dhe paisjet, mirembajtjen e impianteve, bangot e punes, rojet ose ndonje sherbim tjetër.

## **1.6. Hyrja ne sheshin e ndertimit**

Sipermarresi duhet te organizoje punen per ndertimin, mirembajtjen dhe me pas te spostoje dhe ta rivendose cdo rruge hyrje qe do te duhet ne lidhje me zbatimin e punimeve.

C'vendosja do te perfshije pershtatjen e zones me cdo rruge hyrje dhe se paku me shkalle sigurie, qendrushmerie dhe te kullimit te ujrave siperfaqesore te njejte me ate qe ekzistonte perpara se sipermarresi te hynte ne shesh.

## **1.7. Furnizimi me uje**

Uji qe nevojitet per zbatimin e punimeve, do te sigurohet nga vete sipermarresi me shpenzimet e veta.

## **1.8. Furnizimi me energji elektrike**

Sipermarresi do te beje perpjekjet dhe me shpenzimet e tij per furnizimin me energji elektrike ne kantjer. Kur lidhja eshte e mundur mund te merren dhe ne pikat lidhese te investitorit.

### **1.9. Piketimi i punimeve**

Sipërmarresi, me shpenzimet e tij duhet të bëjë ndertimin e modinave dhe të piketave sic kërkohej, në përputhje me informacionin bazë të punedhënesit dhe do të ketë përgjegjësi të vetme për përpikërimet.

Sipërmarresi do të jetë përgjegjës për të kontrolluar dhe verifikuar informacionin bazë që është dhënë dhe në asnjë mënyrë nuk do të lehtësohet nga përgjegjësia e tij nëse një informacion i tillë është i mangët, jo autentik dhe jo korrekt.

Ai nderkohe do të jetë subjekti që do të kontrollohet dhe rishikohet nga punedhënesi, dhe në asnjë rast nuk i jepet e drejta të bëjë ndryshime në vizatimet e kontratës.

Sipërmarresi do të ruajë të gjitha pikat e akseve, modinat, shenjat e kuotave të bërë dhe të vendosura gjatë punës dhe do të mbulojë kostot e rivendosjes së tyre në rast se ato demtohen.

### **1.10. Fotografite e sheshit të ndertimit**

Sipërmarresi duhet të bëjë fotografi me ngjyra sipas udhëzimeve të mbikqyresit të punimeve në vendet e punës për të demonstruar kushtet e sheshit përpara fillimit, progresin gjatë punës, punimet e maskuara dhe mbas përfundimit të punimit.

Shpenzimet për të janë të sipërmarresit të punimeve.

### **1.11. Bashkëpunimi në zonë**

Ndertimi do të bëhet në zonë të kufizuara sipas planimetrisë dhe plan organizimit.

Duhet të kihet kujdes për mundësinë e lëvizjes së kontraktoreve dhe makinerite.

### **1.12. Mbrojtja e punës dhe publikut**

Sipërmarresi i punimeve do të marrë masa paraprake për mbrojtjen e punetoreve të punësuar dhe të punonjësve të tjerë si dhe të pasurive rreth sheshit të ndertimit.

Ai duhet të vejë të gjitha tabelat sinjalizuese dhe parandaluese si dhe ndricimin gjatë natës.

### **1.13. Mbrojtja e ambientit**

Sipërmarresi me shpenzimet e veta duhet të ndermarrë të gjitha veprimet për të siguruar që ambienti, kullimet e ujërave, toka dhe ajri të jenë të pastra nga ndotja për shkak të punimeve.

### **1.14. Transporti dhe magazinimi i materialeve**

Transporti i materialeve nga sipërmarresi do të bëhet me makina të përshtatshme të cilat kur ngarkohen nuk shkaktojnë derdhje dhe ngarkesa të jete të siguruar.

Të gjitha materialet që sillen nga sipërmarresi duhet të stivohen dhe të magazinohen në mënyrë të përshtatshme.

### **1.15. Pastrimi përfundimtar i zonës**

Ne perfundim te punes, sa here eshte e aplikueshme sipermarresi me shpenzimet e tij duhet te pastroje dhe te heqe nga sheshi te gjitha impiantet ndertimore, materialet qe kane tepruar, mbeturinat, skelerite dhe ndertimet e perkoheshme

Ne fund objekti do te jete i pastruar dhe sistemuar.

#### **1.16. Provat**

Ky seksion perfaqeson procedurat e kryerjes se provave per materialet me qellim qe te siguroje ne perputhje me kerkesat e specifikimeve.

Jane te detyrueshme dhe me shpenzimet e sipermarresit provat e betoneve, hekurit, zhavorreve etj sipas kushteve teknike te zbatimit dhe kerkeses se mbikqyresit te punimeve.



# SPECIFIKIME TEKNIKE

## KAPITULLI 2

### GERMIMET

#### TABELA E PERMBAJTJES

- 2.1 QELLIMI
- 2.2 PERCAKTIMET
- 2.3 GERMIMI
- 2.4 PASTRIMI I SHESHIT
- 2.5 PERDORIMI I MATERIALEVE TE GERMIMIT
- 2.6 LARGIMI I UJRAVE NGA PUNIMET E GERMIMIT
- 2.7 HEQJA E MATERIALEVE TE TEPERTA NGA GERMIMI
- 2.8 MATJET

open  
Procurement  
Albania

## **2.1. Qellimi**

Ky seksion permban percaktimet e pergjitheshme dhe kerkesat per punimet e germimeve ne toke. Me tej ajo mbulon te gjitha punimet qe lidhen me konstruksionin e prerjeve, largimin e materialeve te papershtatshme ne hedhurina.

## **2.2. Percaktimet**

Percaktimet e meposhtme duhet te aplikohen:

### **DHERAT**

Germimi ne dhera duhet te aplikohet ne te gjitha materialet qe mund te germohen si me krahe ashtu dhe me makineri.

### **MATERIALE TE PERSHTATESHME**

Materialet e pershtateshme do te perfshijne te gjitha materialet qe jane te pranueshme ne perputhje me kontraten e perdorimit ne punimet dhe qe jane ne gjendje te ngjeshen per te formuar mbushje.

## **2.3. Germimi**

Germimi duhet te kryhet ne perputhje me nivelet dhe vijen e prerjeve sic tregohet ne vizatime. Cdo thellesi me e madhe e germuar nen nivelin e formacionit dhe te projektit duhet te behet mire me mbushje me materiale te pranueshme me karakteristika te ngjashme.

Permasat e prerjeve duhet te jene ne perputhje me detajet e seksioneve terthore tip sic tregohen ne vizatime.

Tabani i themelit duhet te jete horizontal.

Tabani i germuar duhet te ngjeshet perpara hedhjes se materialit te rradhes.

## **2.4. Pastrimi i sheshit**

Te gjitha sheshet ku do te germohet, do te pastrohen nga te gjitha shkurret, bimet, ferrat, rrenjet e medha, plehrat dhe materiale te tjera siperfaqesore ne menyre qe te jete e pelqyeshme nga punedhenesi.

Te gjitha strukturat ekzistuese te identifikuara per tu prishur do te largohen sipas udhezimeve te mbikqyresit te punimeve.

Sipermarresi do te marre te gjitha masat e nevojeshme per mbrojtjen e vijave ekzistuese te ujit, rrethimeve dhe sherbimeve qe do te mbeten ne sheshin e ndertimit. Kosto e pastrimit te kantierit eshte e detyrueshme te paguhet brenda cmimit njesi per punimet e germimit.

## **2.5. Perdorimi i materialeve te germimit**

Te gjitha materialet e pershtateshme dhe te aprovuara te germimit duhet persa kohe ato jane praktike, te perdoren per mbushje dhe sistemime.

## **2.6. Largimi i ujrave nga punimet e germimit**

Si pjese e punes ne zerat e germimit dhe jo me kosto plus per punedhensesin, sipermarresi do te ndertoje te gjitha drenazhet dhe do te realizoje kullimin me kanale kulluese, me pompim, ose me kova si dhe te gjitha punet e tjera te nevojshme per te mbajtur pjesen e germuar te paster nga ujrart deri sa puna e perfunduar te jete e siguruar nga ndertimet.


## **2.7. Heqja e materialeve te teperta nga germimi**

I gjithe materiali i tepert i germuar nga sipermarresi do te largohet ne vendet e aprovuara. Sipermarresi duhet te siguroje kete material nga derdhja ne rruge ose ne vende te shtruara.

## **2.8. Matjet**

Te gjitha zerat e germimeve do te maten ne volum. Matja e volumit te germimeve do te bazohet ne dimensionet e marra nga vizatimet ne te cilat percaktohen permasat e germimeve.

Cdo ndryshim ne nga limitet e percaktuara do te behet me miratimin e mbikqyresit te punimeve.



# SPECIFIKIME TEKNIKE

## KAPITULLI 3

### BETONET

#### TABELA E PERMBAJTJES

- 3.1 TE PERGJITHESHME
- 3.2 KONTROLI I CILESISE
- 3.3 PUNA PREGATITORE DHE INSPEKTIMI
- 3.4 MATERIALET
- 3.5 BETONIMI NE KOHE TE NXEHTE
- 3.6 KUJDESI PER BETONIN
- 3.7 HEKURI I ARMIMIT
- 3.8 KALLEPET OSE ARMATURAT
- 3.9 MATJA E VOLUMIT TE BETONIT DHE CMIMI

### **3.1. Te pergjitheshme**

Puna e mbuluar nga ky seksion i specifikimeve konsiston ne furnizimin e gjithe kantierit,punen,paisjet,veglat dhe materialet dhe kryerjen e te gjitha punimeve ne lidhje me hedhjen,kujdesin,perfundimin e punes se betonit dhe hekurin e armimit.

Punimet betonarme jane te detyrueshme te behen ne nje betoni te certifikuara dhe transportimi dhe hedhja e betonit ne veper do te behet me autobetoniere.

Perpara fillimit te ketij procesi do te merret miratimi nga mbikqyresi i punimeve.

### **3.2. Kontrolli i cilesise**

Sipermarresi do te punesoje inxhinier te kualifikuar,te specializuar dhe me eksperience,i cili do te jete pergjegjes per kontrollin e cilesise te te gjithe betonit.

### **3.3. Puna pregatitore dhe inspektimi**

Perpara fillimit te betonimit behet inspektimi nga sipermarresi dhe mbikqyresi i punimeve per te pare ndertimin e armaturave, hekurit, pastertine e objektit, dimensionet,kushtet per furnizimin me uje per freskim dhe ngurtesim,gadishmerine per vibrim dhe te gjitha procedurat qe kerkohen per cilesine e betonimeve.

### **3.4. Materialet**

Betoni qe do te hidhet ne objekt do te jete i gatshem dhe i pregatitur ne nyjet e certifikuara te prodhimit sipas kerkesave dhe specifikimeve te bera ne vizatimet e projektit dhe preventivit. Transporti dhe hedhja e betonit ne objekt do te behet me autobetoniere dhe beton pompe.

Armaturat e perdorura per kallep do te jene me panele te lyera dhe siperfaqe te pastra.

Cdo autobetoniere duhet te kete minimum 3 kampione per kubike per certifikimin 3,7,28 ditor te betonit

Te gjitha vendet e hedhjes dhe te ngjeshjes se betonit, duhet te mbahen ne mbikqyrje te vazhdueshme nga pjestaret perkates te ekipit te sipermarresit.

Sipermarresi duhet te ndjeke nga afer ngjeshjen e betonit,si nje pune me rendesi te madhe ne arritjen e kerkesave te projektit,objekt i te cilit do te jete prodhimi i betonit te papershkueshem nga uji me nje densitet dhe fortesi maksimale.

Nderprerja e betonit duhet te jete e miremenduar dhe percaktuar nga sipermarresi dhe mbikqyresi i punimeve.

### **3.5. Betonimi ne kohe te nxehte**

Sipermarresi duhet te tregojë kujdes gjate motit te nxehte per te parandaluar carjen apo plasaritjen e betonit. Aty ku eshte e realizueshme, sipermarresi duhet te marre masa qe betoni te hidhet ne mengjes ose naten vone.

### **3.6. Kujdesi per betonin**

Vetem neqoftese eshte percaktuar apo urdheruar ndryshe nga mbikqyresi i punimeve te gjitha betonet do te trajtohen si me poshte:

Siperfaqja e betonit horizontale do te mbahet e laget vazhdimisht per te pakten 7 dite pas hedhjes.

Siperfaqja vertikale do te kujdesen duke lene fillimisht armaturat ne vend pa levizur deri ne momentin e dizarmimit mbasi betoni te jete forcuar.

### **3.7. Hekuri i armimit**

Shufrat e armimit duhet te kthehen sipas masave dhe dimensioneve te vizatimeve. Shufrat duhet te kthehen ne te ftohte.

Hekuri i armimit duhet te jete pa njolla, ndryshk, mbeturina ndertimi apo te cdo lloji materiali qe demton lidhjen e hekurit me betonin.

Perpara betonimit kontrollohet nga inxhinieri i sipermarresit dhe mbikqyresi i punimeve saktesia dhe cilesia e vendosjes se hekurit dhe jepet leja per betonim.

Hekuri duhet te jete i fiksuar dhe mos te krijojë levizje gjate betonimit.

Te gjitha detajet dhe karakteristikat e armimit jane dhene ne vizatimet konstruktive te projektit.

### **3.8. Kallepet ose armaturat**

Armaturat ose kallepet duhet te jene ne pershtatje me profilet, linjat dhe dimensionet e betonimit te percaktuara ne skicat, te fiksuar apo te mbeshetura me morseta dhe distancator apo mjete te ngjashme.

Furnizimi, fiksimi dhe levizja e kallepeve duhet te jete pjese e punes brenda cmimit njesi te paraqitur ne oferten e sipermarresit ne cmimin e betonit.

Armatura nuk duhet te deformohet kur te laget.

Armatura duhet te jete rigjide dhe e fiksuar qe te mos kete asnje levizje gjate betonimit.

### **3.9. Matja e volumeve te betonit dhe cmimi**

Matja e volumit te betonit te derdhur do te bazohet ne permasat e marra nga vizatimet qe lidhen me kete punim.

Cmimi njesi per nje meter kub beton (m3) i derdhur mbulon te gjithe bazen materiale te betonit, transportin, hedhjen ne objekt, nrgjeshjen, armaturen e drrases, cmontimin e armatures se drrases, kujdesin, mbrojtjen, sistemimin e vendit te punes dhe materialeve dhe pastrimin e mbeturinave.

